

Mbahet Liturgjia Hyjnore në Katedralen “Ngjallja e Krishtit” për Kryepiskopin Anastas



Në Katedralen “Ngjallja e Krishtit” po mbahet Liturgjia Hyjnore përpara trupit të Kryepiskopit Anastas.

Liturgjia do të kryesohet nga Mbikqyrësi i fronit Kryepiskopal, hirësi Joanit, Mitropolitit të Korçës.

Pas Liturgjisë do të zhvillohet Shërbesa e Varrimit nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Qindra besimtarë dhe qytetarë kanë qenë pjesë e homazheve për të nderuar kujtimin e Kryepiskopit Anastas.

Sot besimtarë të shumtë, hierarkë të lartë dhe klerikë nga mbarë bota do t’i japin lamtumirën e fundit Kryepiskopit Anastas duke marrë pjesë në shërbesën e varrimit të tij në orën 11:00 në Katedralen Ngjallja e Krishtit.